

Emri i institucionit financiar

Adresa

Data

Aneksi 5. KËRKESA PËR INFORMACIONE SHITESË

Për: **KOMUNA GLLOGOC**

DUKE MARRË PARASYSH SE *PRO MEDICAL* (më tej “Operatori Ekonomik”), pas pranimit të dosjes së tenderit nën Nr. e Prokurimit të sipër-përmendur, beson se nevojiten informacionet shitesë ose informacionet sqaruese si në vijim:

Duke u bazuar në Nenin 53 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), ju drejtohem me kërkesë për sqyrtim dhe modifikim të një pjese të dokumentacionit të tenderit, konkretisht lidhur me Kërkesën 3.

Kërkesa aktuale në dokumentacion:

5. Dëshmi së paku 2 certifikata trajnimi të serviserëve për pajisjet: Selectra Mach5, Selectra S dhe XS, Maglumi X3, Urised & LabUmat.

Kërkesa për modifikim dhe arsyetimi:

Përcaktimi i emrave të caktuar të pajisjeve dhe prodhuesve specifikë krijon një situatë të favorizimit dhe kufizon mundësinë e konkurrencës së lirë dhe të drejtë, në kundërshtim me Nenin 7 të LPP-së, i cili ndalon diskriminimin dhe favorizimin e operatorëve ekonomikë.

Në tregun e Kosovës, OE i autorizuar për këto pajisje ka monopol, dhe shpesh një i vetëm përfaqëson të gjitha pajisjet e listuara dhe ju keni cekur vetem pasijet e ati OE. Si rrjedhojë, kërkesa aktuale përjashton operatorë të tjerë potencialë që janë të aftë teknikisht, por nuk kanë mundësi të pajisen me certifikata për ato pajisje të veçanta.

Sistemet laboratorike kanë ngjashmëri të lartë në aspektin e funksionimit dhe mirëmbajtjes, prandaj kërkesa për certifikim specifik për çdo pajisje është joproporcionale dhe pengon pjesëmarrjen.

Propozimi ynë për modifikim:

5. Dëshmi për së paku 2 serviserë të certifikuar për mirëmbajtjen e pajisjeve laboratorike (pa specifikuar marka apo modele të caktuara).

Ky formulim i ri është më gjithëpërfshirës dhe në përputhje me parimet e barazisë në trajtim, konkurrencës së drejtë dhe mosdiskriminimit të përcaktuara në LPP.

Lidhur me kërkesën tjetër të dokumentacionit:

1. Deklaratë që dëshmon se pjesët rezervë që ndërrohen janë origjinale nga prodhuesi, së paku për pajisjet kryesore: Selectra Mach5, Selectra S & XS, Maglumi X3 dhe LabUmat. Të dorëzohet lista e pjesëve rezervë me kod prodhuesi dhe me garanci minimale 12 muaj.

Sugjerim për përmirësim të kësaj pike: Për të shmangur kufizimin e panevojshëm dhe për të ruajtur cilësinë, propozojmë që formula të jetë si më poshtë:

1. Deklaratë që dëshmon se pjesët rezervë që ndërrohen janë origjinale ose të barasvlershme me origjinalin (me origjinë nga prodhuesi), me garanci minimale 12 muaj.

Sepse të dy kriteret e cekura më lart janë të ndërlidhura dhe në mënyrë të qartë synojnë të favorizojnë një prodhues të caktuar.

Ju lutem mbani parasysh nenin 53.6 të LPP-së, sipas të cilit Autoriteti Kontraktues nuk duhet të zbulojë identitetin e operatorit ekonomik që ka kërkuar këtë sqarim.

Gjithashtu, jemi në dijeni se është e qartë se cili operator ekonomik është i favorizuar dhe pritët të shpërblehet me kontratën përkatëse. Bazuar në kriteret aktuale, të cilat janë të përshtatura në mënyrë të njëanshme, rezulton se është përcaktuar paraprakisht edhe operatori që do të ftohet dhe shpërblehet në këtë tender.

Me respekt,

PRANDAJ, unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar Operatorin Ekonomik, nëpërmjet kësaj kërkoj marrjen e informacioneve të identifikuese.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri OE:	PRO MEDICAL
Adresa e plotë:	KADRI ZEKA, FERIZAJ
Adresa e plotë:	
Emri:	ADNAN BALA
Pozita:	DREJTOR
Nënshkrimi:	
Data:	12.04.2015
Vula:	